

Raport Zmadhim Kapitali

Përgatitur nga: Eftali Qirjaqi, Audituese Ligjore

Adresa: Lagje "Qemal Stafa", Rr. "Studenti", Shkodër

Drejtuar : Z. Alfred Shtjefni & Kolec Shtjefni, Ortak të Shoqërisë Tregtare
"Agro-Alko" Shpk, Shkodër, Albania

Adresa e shoqërisë: Lagjja Zhavor, Rruga e Pistës, Magazine 1-katëshe ne zonën kadastrale
nr.1434, nr. pasurie 506/17, në aksin rrugor Lezhë-Shkodër km 17, Lezhë.

Unë Eftali Qirjaqi, Audituese Ligjore, e liçensuar më datë 11.01.2000, me numër liçense 11, lëshuar nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Rregjistruar më datë 11.01.2000, pranova misionin e ngarkuar nga Ortakët e "Agro-Alko" Shpk, Z. Alfred Shtjefni & Kolec Shtjefni, për të hartuar raportin e zmadhimit të kapitalit, për këtë shoqëri me anë të kalimit në kapital, të rezervave të mbartura dhe fitimeve.

Vendimi i juaj i marrë me datën 20/05/2018, për zmadhimin e kapitalit themeltar, me anë të rezervave dhe fitimeve, kërkon që unë si Audituese Ligjore, të bëj verifikimin e dokumentacionit përkatës që lidhet me pasqyrimin e këtij kapitali (fitimeve) ne bilancet e shoqërisë, të dhënat e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, verifikimin e dokumentacionit kontabël, verifikimin e fitimeve, paraqitja e rregjistrimeve në kontabilitet. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e dokumentacionit, siç janë pasqyrat financiare me pjesët përbërese, të hartuara në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, parimet dhe rregullat e të cilave janë përcaktuar në Ligjin nr.9228, datë 30.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatova se:

Shoqëria "Agro-Alko", është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, regjistruar ne Qkr me numër çeshtjes: CN-437700-04-14. Pjesët e kapitalit zotërohen nga ortakët, Alfred Shtjefni & Kolec Shtjefni me nga 50 % te kuotave secili. Kapitali fillestar para zmadhimit, 100.000 lek. Numri i pjeseve është 100 , vlera e nje pjese para zmadhimit është 1.000 lek. Shoqëria "Agro-Alko" është paisur me numër unik identifikimi të subjektit (NIPT) L38518502U, Adresa: Lagjja Zhavor, Rruga e Pistes, Magazine 1-kateshe ne zonen kadastrale nr.1434, nr. pasurie 506/17, ne aksin rrugor Lezhë-Shkodër km 17, Lezhë. Data e themelimit të Shoqërisë 11/11/2013.

- Vendimi i datës 20/05/2018, i ortakëve të shoqërisë, për zmadhimin e kapitalit nga fitimet dhe rezervat, është marrë pasi shoqëria ka burime aktive për mbulimin e kesaj shtese në formen e Aktiveve materiale, monetare.



- Rregjistrimet në kontabilitet, të vendimit të ortakëve për zmadhimin e kapitalit me anë të rezervave dhe fitimeve do të jenë.

Nr	Llogaritë		Debitohen (pakesohen)	Kreditohen (Shtohen)
	Nr llogarise	Emërtimi		
1	101	Kapitali themeltar		12.290.000
2	118	Rezerva te tjera dhe ligjore	5.200.918	
3	108	Fitimet e ushtrimit 2017	7.089.082	
		SHUMA	12.290.000	12.290.000

KONKLUZIONE

1. Kapitali i themelimit të shoqërisë, i regjistruar para zmadhimit, është **100.000** lekë.
2. Shtesë kapitali me vlerë **12.290.000** lekë, nga fitimet, me vendim ortakëve të datës 20/05/2018.
3. Kapitali i shoqërisë mbas shtesës **12.290.000 leke nga 100.000** lekë, bëhet **12.390.000** lekë.
4. Data e Themelimit të shoqërisë 11/11/2013
5. Vlera nominale e një pjese të kuotave të kapitalit pas rritjes bëhet **123.900** lekë. Numri i pjesëve të kapitalit mbetet **100** pjesë, të cilat zotërohen nga ortakët Alfred Shtjefni & Kolec Shtjefni me 50 pjesë secili. Në % kapitali zotërohet 50 % nga ortaku Alfred Shtjefni dhe 50% nga ortaku Kolec Shtjefni. Ne vlere kapitali **12.390.000** lekë, zotërohet nga Alfred Shtjefni **6.195.000** lekë dhe Kolec Shtjefni **6.195.000** lekë.

Shkodër me 22/05/2018

